REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.34, datë 20/07/2005

"PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE FONDI NË LIMITIN E PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE PËR SHPENZIMET E VITIT 2005, PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT "SHËRBIME SOCIALE PËR FËMIJËT NË RRUGË NË QYTETIN E TIRANËS", FINANCUAR NGA UNICEF"

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, gërma "dh", ligjit Nr.8654, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës", neni 8, gërma "g", ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 "Për buxhetin lokal", ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998 "Për disa ndryshime në ligjin Nr.7776, dt.22/12/1993 "Për buxhetin lokal", si dhe në ligjin Nr. 7892, dt.21/12/1994 "Për sponsorizimet", ndryshuar me ligjin Nr.8282, dt.21/01/1998, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë një shtesë në limitin e të ardhurave për shpenzime në Bashkinë e Tiranës për vitin 2005 në shumën 745.700 lekë.

2. Në zbatim të pikës 1, të miratohet një shtesë në buxhetin e Aparatit të Bashkisë sipas preventivit bashkëngjitur në shumën 745.700 lekë, për zbatimin e projektit "Shërbime sociale për fëmijët në rrugë në qytetin e Tiranës", financuar nga UNICEF.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar dhe Drejtoria e Financës për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI